




Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality Skenderaj

Kuvendi i Komunës/Skupština Opštine/Municipality of Assembly

Në bazë të nenit 43, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, nenin 3 paragrafi 1 pika 1.2 dhe neni 5 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.02/2015 për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, nenit 37 pika 1,3 të Statutit të Komunës së Skenderajt nr.01-110-385, i dt.03.12.2008, si dhe neni 5 Rregullores së Punë se Kuvendit, si dhe ne pajtim me rregullat e procedurës për mbajtjen e mbledhjeve, Kryesuesja e kuvendit, znj. Adelina Spahiu:

THËRRET

Mbledhjen e Rregullt të Kuvendit Komunal të Skenderaj, e cila do të mbahet me datë 29.04.2025, (ditë e marte), me fillim prej orën 10:00, në Sallën e Kuvendit

Mbledhja do të ketë këtë:
REND DITE

1. Fjala hyrëse;
2. Miratimi i rendit të ditës;
3. Shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluara;
4. Vendimi i KQZ-së, për zëvendësimin e anëtares znj.Sala Jashari, me anëtares e kuvendit të Skenderajt znj.Egzona Geci, si dhe dhënia e betimit, (Raporton Kryesuesja e kuvendit, znj.Adelina Spahiu);
5. Shqyrtimi i Raportit financiar tremujor Janar-Mars 2025, me Nr.02-052/01-0013412/25, i datës 11.04.2025, (Raporton Drejtori i DBF-së, z. Ismet Aliu);
6. Propozim-vendim për ngritjen e tarifës së shërbimit për grumbullimin e mbeturinave të ofruara nga KRM, "UNITETI", Sh.A. Mitrovicë, (Ndryshimin dhe plotësimin e nenit 18 paragrafi 1.1 shtojca A, të Rregullores Nr.01-110/04-0005958/23, të datës 31.01.2023 për Menaxhimin e Mbeturinave të Komunës se Skenderajt), me Nr.02-352/01-0010872/25, të datës 24.03.2025, (Raporton U.d. i Kryeshefit ekzekutiv KRM "Uniteti" Sh. A. z.Ylber Murtezaj),
7. Pyetjet e këshilltarëve nën pikat të ndryshme.



KRYESUESJA E KUVENDIT
znj. Adelina Spahiu



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality Skenderaj

Kuvendi i Komunës/Skupština Opštine/Municipality of Assembly

Në bazë të nenit 49, të Ligjit për vetëqeverisje lokale nr. 03/L-040, të Republikës së Kosovës, si dhe nenit 43 të Statutit të Komunës së Skenderajt Nr.01-110-385, të datës 03.12.2008, si dhe Rregulloren e Punës së Kuvendit nenit 27, c në pajtim me rregullat e procedurës.

Ekstrakt nga procesverbalit i MBLEDHJES SË KUVENDIT KOMUNAL SKENDERAJ,
i datës 01.04.2025, ora 10:00

Në këtë mbledhje janë diskutuar këto pika:

1. Fjala hyrëse;
2. Miratimi i rendit të ditës;
3. Shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluara;
4. Propozim-vendim për shpalljen "Qytetar Nderi" të Komunës së Skenderajt z.Vaughan Smith, Nr.02-170-01-0010227/25, të datës 17.03.2025, (Raporton Kryetari i Komunës **z. Fadil Nura**),
5. Propozim-vendim për ngritjen e tarifës së shërbimit për grumbullimin e mbeturinave të ofruara nga KRU, "Uniteti", Sh.A. Mitrovicë, (Ndryshimin dhe plotësimin e nenit 18 paragrafi 1.1 shtojca A, të Rregullores Nr.01-110/04-0005958/23, të datës 31.01.2023 për Menaxhimin e Mbeturinave të Komunës së Skenderajt), me Nr.02-352/01-0010872/25, të datës 24.03.2025, (Raporton Kryetari i Komunës **z. Fadil Nura**),
6. Pyetjet e këshilltarëve nën pikat të ndryshme.

Kryesuesja e kuvendit, Adelina Spahiu: Të nderuar anëtar të kuvendit, drejtor të drejtorive, dhe gjithë ju të pranishëm, shkojmë në konstatime të kuorumit, në sallë janë 24 anëtar, mungojnë me arsye Azem Gashi, Musa Fazliu, Ragip Durmishi, Arjeta Rama dhe Besnik Ahmeti, bashkëngjitet mbledhjes Alketa Mecini.

-Shkojmë me miratimin e rendit të ditës, e hap debatin, nëse nuk ka, shkojmë në votim; Konstatohet me (19) vota për, (3) kundër dhe (2) abstenim, miratohet Rendi ditës.

Vazhdojmë me piken 3 të rendit të ditës,

-Shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluara, e hap debatin, nëse nuk ka shkojmë në votim; Konstatohet me (24) vota për, (0) kundër dhe (0) abstenim, miratohet Procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Vazhdojmë me piken 4 të rendit të ditës;

-Propozim-vendim për shpalljen "Qytetar Nderi" të Komunës së Skenderajt z.Vaughan Smith, Nr.02-170-01-0010227/25, të datës 17.03.2025, (Raporton),

Kryetari i Komunës, Fadil Nura: Fjala përshëndetëse, kam nderin që para vetes e keni Propozim-vendim për shpalljen "Qytetar Nderi" të Komunës së Skenderajt video-gazetari, foto-reporteri Britanik, z.Vaughan Smith. Titulli "Qytetar Nderi", të Komunës së Skenderajt, i ndahet, në shenjë respekti dhe mirënjohje për kontributin e dhënë në pasqyrimin e realitetit dhe sensibilizimin e opinionit ndërkombëtar për luftën e UÇK-së në zonën e Drenicës, prandaj gjurmët edhe sot e asaj dite janë dëshmitar që kanë prezantuar luftën e drejtë të popullit të Kosovës, Titulli "Qytetar Nderi" të Komunës së Skenderajt z.Vaughan Smith, do ti ndahet në seancën solemne, që do të mbahet më 18 Qershor 2025, në Ditën e Çlirimit të Skenderajt.

Kryesuesja: E hap debatin, nëse nuk ka, shkojmë në votim. Konstatojmë me (24) vota për, (0) kundër dhe (0) abstenim, miratohet Propozim-vendim për shpalljen "Qytetar Nderi" të Komunës së Skenderajt z.Vaughan Smith.

Vazhdojmë me pikën 5 të rendit ditës,

-Propozim-vendim për ngritjen e tarifës së shërbimit për grumbullimin e mbeturinave të ofruara nga KRU, "Uniteti", Sh.A. Mitrovicë, (Ndryshimin dhe plotësimin e nenit 18 paragrafi 1.1 shtojca A, të Rregullores Nr.01-110/04-0005958/23, të datës 31.01.2023 për Menaxhimin e Mbeturinave të Komunës së Skenderajt), Nr.02-352/01-0010872/25, të dt. 24.03.2025, (Raporton),

Kryetari i Komunës, Fadil Nura: Para vetes e kemi Propozim-vendim për ngritjen e tarifës së shërbimit për grumbullimin e mbeturinave të ofruara nga KRU, "Uniteti", Sh.A. Mitrovicë, një kërkesë të iniciuar nga KRU, "Uniteti", për ngritjen e tarifës për 1€, përkatësisht Ndryshimin dhe plotësimin e nenit 18 paragrafi 1.1 shtojca A, të Rregullores për Menaxhimin e Mbeturinave të Komunës së Skenderajt, unë e kam pas një takim me drejtorin ekzekutiv regjional dhe në parim kam qenë pak skeptik, po me arsyetimin e kompanisë që ka shpenzime të mëdha, dhe komuna e Skenderajt e ka tarifën me të ulët në rajon në krahasim me regjionet tjera, dhe unë e kam prezantua kërkesën e tyre në kuvend që ta diskutojmë bashkarishtë dhe është vullneti i juaji a jeni për me ngrit apo jo këtë tarifë. Kompania ka shpenzime të mëdha në amortizimin të makinerisë dhe me këtë vlerë është e pamundur me ja dalë me i krye shërbimet qysh dojm ne. Kompania ka probleme edhe në menaxhim kam kërkuar raporte të auditimit dhe çështje tjera. Si ekzekutiv jemi tu e shqyrtua edhe mundësin e veprimit qysh ka veprua Vushtrria që me kalua në kompani lokale. Kjo rritje unë mendoj është një hap i mirë që ma ja dhënë një mundësi që kompania me u fuqizua në kuptimin e ofrimit të shërbimeve që kërkohen nga qytetaret.

Kryesuesja: E hap debatin, fjalën ja kaloj;

Besart Rrecaj-PDK: Fjala përshëndetëse, sa i përket kësaj pike për ngritjen e çmimit të mbeturinave, në parim nuk mundem me thanë as pajtohem as nuk pajtohem, me shikua drejtë me 5€ është vështirë me i mbulua shpenzimet, po jemi në një kohe ku gjendja ekonomike nuk është shumë e favorshme, niveli qendror po e rritë çmimin e energjisë, dhe kjo kish me pas me shume ndikim psikologjik, së kjo nuk është që qon shume peshe ngritje prej 1€. A ekziston mundësia që me u gjind ndonjë alternativ që me u bë ndonjë ndihmë ndonjë pagesë prej buxhetit të komunës së paku për këtë vit, që me u pasqyrua në buxhetin e konsumatorit?

Naser Bajraktari-IDEAL: Fjala përshëndetëse, Duke u bazuar në propozim vendim për ngritjen e tarifës për mbeturina nga 5 € në 6 € për Amvisëri ne grupi i asamblistëve IDEAL-it jemi kundërt shtrenjtimit të tarifës për mbeturina mbi 20% për ekonomit familjare pasi që kjo kompani është duke u keq menaxhuar. Kryetarë po me duket se po merreni modelin e Kryeministrin për ngritjen e tarifës për energji elektrike prej 15% në bashkëpunim me ZRRE-në, vetëm ju po dalloni në taksa komunale, si me kane të një kabineti qeveritar po dukeni, si me politika ashtu edhe me vendime. Ku dihet se numër i ekonomive që janë në shërbim është mbi 6,000 ekonomi familjare, numeri i bizneseve është mbi 500 biznese dhe mbi 70 institucione komunale, këto ekonomi dhe institucione kompanisë Uniteti njësisia në Skenderaj i sjellin të hyra mbi 450,000 € në vit. Një kompani që ka 50 punëtorë dhe që ka një buxhet prej 450,000€ në vit dhe prapë kërkon rritje të taksës është absurditet i lloji të vete. Unë si asamblistë kam propozuar sa më parë të behet ndarja prej regjionit, duke marrë për shembull Komunën e Vushtrisë, po si duket jeni vonuar në këtë proces dhe prapë po kërkon shtrenjtimin e tarifës pa pasur një pasqyrë të gjendjes së kësaj kompanie e cila çdo ditë e me shume po keqpërdore të hyrat e tarifës për mbeturina, dhe një herit po keqpërdor taksapaguesit e komunës tone. Duke marrë për bazë se në këtë ndërmarrje veç në njësinë në Skenderaj janë dy menaxher dhe një zëvendës menaxher, çka është edhe me skandaloze për këtë

propozim, nuk keni marr guximin me sjell raportin e auditorit, ku duhet me raportuar anëtar i bordit z.Faton Zeka i cili ne baza mujore paguhet për menaxhimin dhe mbikëqyrjen e kësaj ndërmarrje. Me qene se keni sjelle këtë propozim unë kam disa pyetje: 1.Ku është raporti i auditorit për vitin 2023-2024 për KRM UNITETI SH.A Mitrovicë pse nuk e keni sjell këtë raport?

2.Pse nuk e keni sjelle listën e punëtorëve të njësisë në Skenderaj, me dite sa janë pagat?

3. Sa janë shpenzimet për paga, për derivate, për mirëmbajtjen e makinerisë, për qiranë e zyre se menaxhmenti, ku dihet se është ndërtuar objekti i ri? 4.Edhe në seancën e datës 30.07.2024 kam ngritur shqetësimin se ju po i përdorni si pretekst rritjen e tarifës kinse rritjen e pagave, ndërsa ende një pjesë të punëtorëve nuk jave keni rritë pagën? 5. Në bazë të raportit nga muaj shkurt 2023 ju keni rrite rogat për nga 100€, punëtorëve të operatives, po nuk jave keni rrit pagën punëtorëve të makinerisë dhe kryepunëtorit të operatives? 6. Pse elektrikistit të makinerisë z. Shaip Dibrani i cili ka të vrare katër anëtar të familjes gjatë luftës, Nene me tri motra i cili nuk e ka gjendjen e mirë ekonomike pse nuk e keni ngrit këtë çështje ku qëndron problemi?

-Çka është për tu çuditura edhe militantit të juaj të PDK-se nuk ja keni rrit pagën si pretekst mos me ja rrit rrogën prej 100€, në këtë ngjarje është në dijeni edhe asamblisti i juaj z.Fikret Rexhepi ku punëtorët e uniteti e kanë informuar për këtë probleme, që nuk me besoni mua pyetni Fikret Rexhepin nëse guxon me thanë të vërtetën?. 7. Pse punëtorët e operatives nuk kam uniforma, ku dihet se janë të rrezikuar në rrugë dhe nga infektimi gjatë punës? 8.Cila është gjendja e kamionëve të njësisë, ku dihet se një numër i makinerisë edhe në cunga që rrinë po ju shpenzojnë naftë?

Këtu ka më shumë keq menaxhim nga regjioni apo njësia në Skenderaj, pasi që komunën e Skenderajt e përfaqëson edhe një anëtar i bordit, z. Faton Zeka, kisha pas dëshire me dite a ju ka sjell raportin e auditorit për të analizuar gjendjen e kompanisë Uniteti njësia në Skenderaj. Kryetar mos hezito në si asamblistë të IDEAL-it jemi të gatshme të mbështesim në shkëputjen e njësisë Uniteti në Skenderaj, për të ju bashkuar ndërmarrjes komunale Eko Natyra Sh.A sikurse ka bërë Komuna e Vushtrrisë me ndërmarrjen Përparimi Sh.A.

Hysni Mehani-LVV: Në parim nuk po dua me sulmua as me mbrojt askënd, nuk po dua me i dhënë nuancë politike kësaj çështje. Po i ngriti dy çështje, në aspektin procedural, a është në rregull, Ndryshimin dhe plotësimin e nenit 18 paragrafi 1.1 shtojca A, të Rregullores për Menaxhimin e Mbeturinave, më vendim, desha drejtori i administratës me na ndihmua, a është në rregull ky ndryshim i kësaj rregullore me vendim, nëse po në cilat raste parashihet? U përmend ndarja nga KRM, "Uniteti", Sh.A. Mitrovicë, kur dikush e përmend ndarjen duhet me pas një analizë, duhet me u bazua në fakte, që me na kushtua më lirë neve si komunë. Unë jetoj në lagjen 3 në Skenderaj, nuk po dua me i hi në hak kësaj kompanie, sot i hedha mbeturinat, sot të martën, erdhën i murrën mbeturinat, i di manipulimet i di fjalët e errëta për menaxhimin për manipulimet, po fakte nuk kam mundur me i pa hala për me i dorëzua në prokurori, po të na çdo të marte vinë i marrin mbeturinat.

Mentor Mehmeti-PDK: Fjala përshëndetëse, kompania e unitetit normalisht i kryen disa obligime në qytetin tonë, po në pah është Eko-Natyrë, d.m.th. nëpër qytet pastrimin e kryen Eko-Natyrë dhe shumica e qytetarëve kur e kanë pa këtë rritje kanë mendua që rritja po shkon për Eko-Natyrën, dhe janë të kënaqur me pastrimin e qytetit. Unë e di që ka me efektua shumë në gjepin e qytetarit pavarësisht gjithave, më këtë rritje me shikua a rritet menaxhimi efikasiteti neper fshatra, dhe si propozim e kisha lanë që këtë pikë me ardhur me raportua dikush prej Unitetit me një raport me të qartë.

Kryesuesja: Fjalën ja kaloj;

Kryetari i Komunës, Fadil Nura: Uniteti është kompani regjionale është e pa nevojshme me sjellë listën e punëtorëve që paguhet dhe shpërndarja e pagave nuk e kemi në kontroll, kjo

kompani relativisht po përformon mirë, po kemi probleme në zonat rurale. Kompania ka probleme në vendimmarrje dhe mungesa e vendimmarrjes krijon probleme tjera, e ka një pikë që inkason me qira dhe është në përgjegjësin e tyre, qysh është ujesjellësi, nuk mundem me i ndërhy në këto çështje. Procedura është në rregull për plotësimin-ndryshimin e një nenit të një rregullores, po procedura e diskutimit publik i nënshtrohet ku ka ndryshime mbi 40%, dhe ligjërisht jemi gjithëka në rregull dhe nuk besoj që ka probleme.

Kryesuesja; Fjalën ja kaloj;

Hysni Mehani-LVV: Edhe dy pyetje shtesë, për sqarim, për drejtorin e financave, 1.Sa mjete ja keni nda eko-natyrës brenda viti,? Edhe eko-natyrë e pastron qytetin po mbeturina a i len ne kontejnerë që me ardhur uniteti me i marr, apo qysh i menaxhon eko-natyrë pastrimin e qytetit, mbeturinat ku po mbesin?

Kushtrim Draga-PDK: Fjala përshëndetëse, për shërbimet e kompanisë Uniteti e kam pas një pyetje me herët, të na në Leqin, i kanë anëtarësuar disa shtëpi, po shërbime nuk marrin asnjëherë, dhe arsyeja e kompanisë është që nuk kemi kamiona me shkua atje me i marr mbeturinat, dhe ka pas njerëz që prej 8 vite s'kanë operua hiq në biznes dhe pas 8 vite kur ja kanë filluar me operua, Uniteti e ka qua të përmbaruesi, edhe unë e kam friken që të njëjtën send ka me ja bë qytetarëve të cilët e kanë kontratën kur e din që prej 2021 para zgjedhjeve janë shpërnda kontejnerë neper BL-Runikut, ka familje që i kanë marrë ka 2-3 kontejnerë e janë 2-3 të shkruar prej një shtëpie që kanë kontejnerë, ja nuk janë të informuar qytetarët që uniteti ka mi qua të përmbaruesi dha uniteti nuk ja sqaron edhe pse nuk shkon me ja marr mbeturinat, që herdo kurdo ka mi nxjerr parat. Për ngritjen e ekonomive familjare, kisha kërkuar me pas një ndryshim edhe të bizneset , ku bizneset e kanë tarifën e njëjtë si një biznes i vogël si p.sh, frizerat, dhe maketet e vogla, si një librari si një kafe, dhe mendoj që me gjete një model me unitetin me bë një ndryshim të bizneset në bazë të sasisë së mbeturinave sepse është e padrejtë, dhe nëse kish pas mundësi me shty për një seancë tjetër këtë pik dhe me bë ndryshimin për të dyat?

Ali Lutfiu-PDK: Fjala përshëndetëse, në qoftë së kjo rritje e prek direkt pagën e punëtorëve unë jam në rregull, sepse kjo dihet këta punëtor janë heronjtë e qytetit dhe i vlerësoj shume, dhe në kohën e pandemisë të vetmit këta punëtor janë kanë ma të rrezikuar prej infeksioneve, dhe në qoftë së kjo rritje i prek në paga është në rregull, së nëse vazhdon kështu në një kohe shumë të afërt kemi me mbet pa këta punëtor.

Besiana Thaçi-PDK: Fjala përshëndetëse, sa i përket kësaj pike dhe kërkesës së kompanisë për ngritjen e çmimit nga 5€, në 6€, unë po flas sa i përket dëgjimeve publike që i kemi pas në BL-Turiqecit, kanë qenë të pranishme drejtori z.Mulaj, dhe z.Aliu, dhe shqetësimi i banorëve ka qenë keq menaxhimi i mbeturinave nga kompania, sidomos gjatë sezonit të verës, prandaj edhe kjo e arsyeton vendimin tim për votën time sa i përket kësaj pike duke i dëgjuar ankesat e banorëve nuk mundem me ardhur këtu me votua pro kësaj pike, faleminderit.

Naser Bajraktari-IDEAL: Kryetar thash me sjell listën e pagave dhe të shpenzimeve sepse ky kuvend nuk i dinë të hyrat dhe shpenzimet e kësaj kompanie, me ditë sa kanë paga, sa kanë të hyra. Sa i përket shërbimit shërbimi nuk është 100% i mirë, po mundem të themi se dikun ka mungesa me ka një javë po janë probleme që ndodhin të çdo kompani. Kam dëshirë me ditë sa është borqi kjo kompani që e dinë edhe ti kryetar, që kjo ndërmarrje është borqe deri në fyte, edhe nuk mundem me i ndihmua pa e pa sa është borq, s'kemi dokumente me ditë sa është, se punëtoret nuk kanë veshmbathje, me veshmbathje private punojnë në teren.

Liridona Koci-PDK: Fjala përshëndetëse, lidhje me këtë çështje siç e përmendi edhe kryetari ne kemi ndërmarr hapa edhe me parë, nga 4.50€, e kemi rritë në 5€, shërbimin e mbeturinave, mirëpo nuk kemi pa ndonjë rezultat pozitiv lidhje me menaxhimin e mbeturinave nga kompania, dhe nuk

besoj që as me 6€ s'kemi me pas ndonjë rezultat pozitiv. Me ardhjen e materialit të seancës kam bisedua me disa banorë të fshatit Polac, dhe ata janë tejte të zhgënjyer me ndërmarrjen në fjalë me qenë së shërbimet janë në nivel të jetë të ulëta. Dhe përderisa kompania të ndërmerr hapa pozitiv të sjellin me fakte së do të jenë shërbimet me cilësore dhe denjitetshme unë nuk do të përkrahë këtë rritje.

Miradije Buliqi-PDK: Fjala përshëndetëse, sa i përket kësaj pike propozoj për shkak të arsyetimeve që i dhanë të gjithë me u shty për një seancë tjetër dhe me u hedh në diskutim publik me qytetaret dhe bizneset dhe me vendos bashkërisht rreth kësaj pike për këtë rritje të mbeturinave.

Afrim Kabashi-NSD: Pajtona me të gjithë parafolësit që kjo pikë të shtyhet për një seancë tjetër dhe të sjellët një raport me i detajuar dhe për me vendos për këtë rritje.

Kryesuesja: Fjalën ja kaloj:

Kryetari i komunës, Fadil Nura: Ju dëgjova me vëmendje, e lajm e thirrëm një përfaqësues të unitetit ose u.d. e drejtorit me ardhur me dhënë një raport me të detajuar, dhe me na dhënë me shumë sqarime. Verën e kaluar kemi pas probleme me mbeturina edhe ne qytet, sepse janë kanë dy kamionë defekt, po tash kemi performanc me të mirë, nuk jemi të kënaqur 100%, po krejt keq nuk është. Mitrovica është e gatshme me i rritë rrogat e punëtorëve, po ne nëse nuk e rritemi këtë, punëtorët e komunës së Skenderajt jesis me këtë rroge që e kanë, dhe kjo me bëri që këtë pikë me sjellë në kuvend. E di që kjo kompani ka probleme, e vlerësoni ju e lajmë në një seancë tjetër e thirrëm një përfaqësues me na jap sqarime me të detajuar për pyetje rreth menaxhimit, dhe është ne vullnetin e juaj dhe unë jam për me përkrah edhe pse jam kanë skeptik.

Kryesuesja: Fjalën ja kaloj:

Hysni Mehani-LVV: Nuk morra prej drejtorëve përgjigje, na qysh e dimë përzgjedhja e anëtarëve njeri borde të kompanive, pak si përshtjellte pa gjithë përfshirje, na e kemi dikë në bordin e unitetit që ka marrë mandatë prej këtij institucioni dhe aj do duhej me raportua edhe ekzekutivit edhe kuvendit dhe aj anëtar do duhej me i pas këto të dhëna dhe me na sjellë dhe me ardhur me u përgjigj. Tjetra, kush donë informacione shtesë ata e kanë një email zyrtar dhe mundesh si institucion dhe individualisht kërko qasje në dokumente zyrtare.

Besart Rrecaj-PDK: Prej momentit që e kam pa materialin jam kanë kundër, edhe sot jam kundër, mirëpo nëse kjo rritje e prek automatikisht rrogën e punëtorëve unë votoj pro kësaj rritje.

Besiana Thaçi-PDK: Koleg unë nuk e di ku murrët ju garanci që nëse votohet kjo rritje, kanë me ju rritë pagat punëtorëve, nuk është përgjithësi e komunës që me ju rritë rrogat e punëtorëve të kompanisë unitetit, nuk është arsye kjo.

Kryesuesja: Fjalën ja kaloj:

Kryetari i komunës, Fadil Nura: Na e kemi anëtarin në bord, po anëtar i është në vendimarrje, nuk mundet me u përgjigj në menaxhim, dhe nuk mundem me ju garantua që do të këtë rritje pagave punëtorëve, mua u.d. të kryeshefi me ka thënë kemi marr iniciative që në Mitrovicë me pas rritje të pagave të punëtorëve, po në Skenderaj duhet me u be kjo rritje të shërbimit për me pas rritje të pagave, dhe kjo me shtyu mua me sjell këtë pik. Kështu që nëse jeni të gjithë dakord e shtymë për seancën tjetër, vjen me një raport menaxhmenti, ne seancë.

Drejtori i DBF, Ismet Aliu: Fjala përshëndetëse, subvencione gjatë vitit 2024 për eko-natyrën nuk ka pas, po është ndihmua nga grandit i performances me ngritje të kapaciteteve me furnizim të pajisjeve në vlerë 80 mijë €. Ndërsa për vitin 2025 është marr një vendim në vlerë prej 30 mijë, që është ndihmua eko-natyrë.

Kryesuesja: Alketa Mecini është bashkangjitur seancës, me kaq mbyllet debati, me qenë së jeni të pajtimit për me shtytë këtë pik, për seancën tjetër, shkojmë në votim për shtyrje, Konstatohet me (27) vota për, (0) kundër dhe (2) abstenim, shtyhet për seancën tjetër, Propozim-vendim për

ngritjen e tarifës së shërbimit për grumbullimin e mbeturinave të ofruara nga KRU. "Uniteti", Sh.A. Mitrovicë, (Ndryshimin dhe plotësimin e nenit 18 paragrafi 1.1 shtojca A, të Rregullores Nr.01-110/04-0005958/23, të datës 31.01.2023 për Menaxhimin e Mbeturinave të Komunës së Skenderajt), Nr.02-352/01-0010872/25, të dt. 24.03.2025.

Vazhdojmë me pikën 6 të rendit ditës,

Pyetjet e këshilltarëve nën pikat të ndryshme, fjalën ja kaloj,

Afrim Kabashi-NSD: Pyetje, për Drejtorin e Bujqësisë Behxhet Maliqi? Drejtor cilat janë arsyet e mos vazhdimit të projektit të subvencionimit të fermerëve me fidanë të pemëve, projekt i paraparë për 3 vite? 2. Për Drejtorin për Urbanizëm Driton Mulaj; Drejtor a keni parapa në muajt e mbetur të qeverisjes në rregullimin e infrastrukturës mbrapa qendrës zejtare?

Kryesuesja: Fjalën ja kaloj:

Drejtori i DBPZHR-së, Behxhet Maliqi: Fjala përshëndetëse, realisht ne jemi në një kontratë kornizë, besoj që këtë vitë ka me përfundua kontrata dhe jemi afër hapjes së thirrjes tjetër për zhvillim të këtij aktiviteti.

Drejtori i DUMA-së, Driton Mulaj: Sa i përket rregullimit, parkingut prapa qendrës, varësisht nga mundësia buxhetore shohim a po kemi mundësi me i trajtua apo jo, qysh ka qenë gjendja është e mirë po jo e këndshme.

Kryesuesja: Fjalën ja kaloj:

Abdulla Gashi-IDEAL: Pyetje për Drejtorin e Inspektoratit Valon Haliti; 1. Drejtor, a keni mundësi të na përgjigjeni rreth ndërtimeve të egra që po ndodhin në komunën tonë? 2. Drejtor, sa jeni duke i mbikëqyrë ndërtimet? A po ndërtohen sipas standardeve që parashihen edhe me ligj?

Drejtori i DI-së, Valon Haliti: Fjala përshëndetëse, sa i përket ndërtimeve në territorin e komunës së Skenderajt mundem me të sigurua që 100% të ndërtimeve të larta janë të pajisur me leje ndërtimore, së cila kompani e ka inxhinierin mbikëqyrës të publishtesë, e cila për çdo fazë ndërtimore bënë kërkesë në drejtorin për inspeksion, dhe inspektorati e mbikëqyr çdo fazë të objektit.

Kryesuesja: Replikë 1 min.

Abdulla Gashi-IDEAL: Drejtor, e kuptoj shumë mirë që sa i përket ndërtimeve ju me dokumentacion i rregulloni, por në realitet nuk besoj se po kryhen sipas standardit të kërkuar. Ju lutem, mos lejoni ndërtime që nuk i plotësojnë kriteret, sepse kjo ka të bëjë me jetën e njerëzve.

Pyetje për Drejtorin e Shërbimeve Publike – Alban Shala; 1. Drejtor, çfarë është duke ndodhur me ndriçimin nëpër fshatra? A është në përfundim? 2. Drejtor, çfarë keni paraparë për largimin e mbeturinave inerte dhe të tjera, që po e shëmtojnë natyrën?

Drejtori i DSHP-së, Alban Shala: Sa i përket projektit për ndriçimin publik në tërë territorin e komunës së Skenderajt punimet janë tu u zhvillua sipas planifikimeve që është kontratë kornizë 3 vjeçare, kompania është tu punua në Klinë të epërme, dhe në Laushë, dhe së shpejti vinë edhe në Kryshec sipas planifikimeve. Sa i përket mbeturinave inerte, ka muaj maj, e marrim një aksion për largimin e këtyre mbeturinave në tërë territorin e komunës së Skenderajt, sepse këto mbeturina po përsëritën kohe pas kohe.

Kryesuesja: Replikë 1 min.

Abdulla Gashi-IDEAL: Drejtor, sa i përket ndriçimit nëpër fshatra, keni anashkaluar disa lagje, përfshirë lagjen ku jetoj unë në fshatin Kryshec dhe lagjen Kuqica të Marinë, ku nuk është vendosur asnjë ndriçim, ndërsa përreth lagjes time janë vendosur. Kjo i bie hakmarrje politike. Sa i përket deponive inerte, çdo ditë po shtohen këto deponi, sidomos në fshatin Marinë, fshatin Rezall, rrugën Skenderaj që e lidh me fshatin Kryshec dhe zona të tjera. Kërkoj që të merren masa për ndalimin e tyre. Për Drejtorin e Urbanizmit Driton Mula, Drejtor, disa herë e kam

ngritur këtë çështje për rrugën në fshatin Turiqec, që lidh familjen e Sali Berishës, e cila ka qenë në gjendje të keqe. Më në fund keni bërë një punë të mirë, por kërkoj nga ju që kjo rrugë të asfaltohet me mundësitë buxhetore që ka komuna. Ju kam thënë se kur të kryeni një punë të mirë, do t'ju përgëzoj. Faleminderit!

Kryesuesja: Pyetjen e drejtorit të Arsimit dhe pyetjet e Musa Fazliut të kalojnë në seancën tjetër, fjalën ja kaloj;

Mentor Mehmeti-PDK; Pyetje për: Drejtorin e Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, z. Shahin Tahiri; I nderuar Drejtor, Pas raportimeve për dhunimin e një gruaje me aftësi të kufizuara në fshatin Syriganë, shprehim shqetësimin tonë të thellë dhe shpresojmë që raste të tilla të mos përsëriten. Në kuadër të kompetencave tuaja si institucion, a i është ofruar viktimës trajtimi i nevojshëm psikologjik dhe mbështetja e duhur për tejkalimin e kësaj situatë? Gjithashtu, cilat hapa janë ndërmarrë për të garantuar mbrojtjen dhe mirëqenien e saj? Faleminderit!

Kryesuesja: Fjalën ja kaloj;

Drejtori i DSHMS-së, Shahin Tahiri: Fjala përshëndetëse, sa i përket rastit në fjalë janë marr masa, mirëpo familja nuk ka pranuar që e dëmtuara të shkojë në strehimore, kurse për procedurat tjera janë tu u marr prokuroria, me rastin.

Kryesuesja: Me kaq mbyllet kjo mbledhje, shihemi në mbledhjen tjetër.

Procesmbajtësi

Kryesuesja e Kuvendit



Komisioni Qendror i Zgjedhjeve • Centralna Izborna Komisija • Central Election Commission
Republika e Kosovës • Republika Kosova • Republic of Kosovo

KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE, në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 10 dhe nenin 3 paragrafi 3.2 të Ligjit Nr.03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, nenin 37 paragrafi 2 nën paragrafi c dhe 37 paragrafi 3 të Ligjit Nr.03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 3, nenin 5, paragrafi 5.1.3 dhe 5.1.9, nenin 6 dhe nenin 7 të Udhëzimit Administrativ Nr.01/2017 për Zëvendësimin e Anëtarit të Kuvendit Komunal, në mbledhjen e rregullt të mbajtur më datë 03.04.2025, nxjerr këtë:

VENDIM

Për Emërimin e Anëtares të Kuvendit Komunal

- I. **Znj.Egzona Geci**, emërohet anëtare e kuvendit komunal në Skenderaj, nga subjekti politik "Lista e Pavarur Bekim Jashari", duke e zëvendësuar anëtarin e kuvendit komunal znj.Sala Jashari.
- II. Obligohet Sekretariati i KQZ-së, që ky vendim t'i komunikohet znj.Egzona Geci dhe të ndërmerren veprimet procedurale për zbatim.
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, ka shqyrtuar shkresat e lëndës të dorëzuara në KQZ më datën 03.04.2025, Nr.07/7-816/2025, për zëvendësimin e anëtares të kuvendit komunal znj.Sala Jashari, e cili ka dhënë dorëheqje për arsye të zgjedhjes deputete në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Pas shqyrtimit të kërkesës dhe shkresave të bashkangjitura, është verifikuar dhe konstatuar se, kandidatja e radhës në listën e rirenditur është znj.Egzona Geci. Kandidatja e radhës ka dhënë deklaratën e pranimi të mandatit, nga i njëjti subjekt politik, e gjinisë së njëjta me numër më të madh të votave duke mos tejkaluar kuotën prej 30 % , të kufirit minimal të përfaqësimit gjinor të gjinisë pakicë, sipas rezultateve të certifikuar të zgjedhjeve lokale të vitit 2021. Andaj, pas plotësimit të kushteve ligjore, KQZ vendosi si në pikën I të këtij vendimi.

Prishtinë, 03.04.2025





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komunës Skenderaj
Opštine Skenderaj
Municipality Skenderaj

Kuvendi i Komunës/Skupstina Opštine/Municipal Assembly

Bazuar në nenin 35 paragrafi 4 të Ligji Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta zyrtare e republikës së Kosovës” Nr.28/15, qershor 2008), para juve do ta jep këtë:

B E T I M

Unë, (Egzona Geci) “betohem (ose deklaroj solemnisht) se do t’i kryej me nder, besnikëri, pa anime e me ndërgjegje dhe sipas ligjit detyrat dhe do t’i ushtroj autorizimet e mija si anëtare e Kuvendit të Komunës së Skenderajt, në mënyrë që të sigurohen kushte për jetë të qetë për të gjithë”.

SKENDERAJ

DATA: _____

ANËTARE E KUVENDIT

Egzona Geci



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI KOMUNAL / ASSEMBLY OF MUNICIPALITY / SKUPŠTINA OPŠTINE
SKENDERAJ

Nr.
No. 02-052/01-003412/25
Data
Date 11-04-2025



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Zyra e Kryetarit / Kabinet Predcednika / Office of the Mayor

RAPORTI FINANCIAR
TREMUJOR
Janar – Mars 2025

Prill 2025

Përmbajtja:

Raporti Financiar tremujor Janar-Mars 2025.....	3
1. Kërkesat për raportim	3
2. TË HYRAT DHE SHPENZIMET BUXHETORE PËR PËRIUDHËN RAPORTUESE ...	3
3. Raporti i Ekzekutimit të Buxhetit 2025 TABELA Nr 1	4
4. TË HYRAT VETANAKE JANAR-MARS 2025	5
Te hyrat Vetanake komunale - Janar-mars 2025	5
5. SHPENZIMET BUXHETORE	7
Tabela nr. 4 Projektet kapitale të realizuara Janar-mars	9
6. Shpenzimet analitike sipas drejtorive dhe zyrave	12

Raporti Financiar tremujor Janar-Mars 2025

Kërkesat për raportim

Raporti Financiar tremujor Komunal për periudhën Janar – Mars 2025, përgatitet në bazë të kërkesave për raportim të përkohshëm dhe vjetor bazuar në dispozitat e neneve 45.4 dhe 46.2 të Ligjit Nr.03/L-048 “Për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë” dhe statutit Komunal.

Raporti Financiar Komunal ka për qëllim të informimit objektiv lidhur me ecurinë dhe me treguesit relevant rreth përmbushjes së planit të grumbullimit të mjeteve sipas burimeve, përmbushjes së obligimeve të planifikuara sipas plan programeve, dinamikën e mjeteve të shpenzuara dhe atë sipas natyrës së shpenzimeve dhe kategorive të përcaktuara buxhetore, rrjedhën e parasë si dhe treguesit tjerë që kanë ndikuar në rezultatet e përgjithshme për këtë periudhë.

Periudha e raportimit karakterizohet me faktin se:

- Ekzekutivi rrjedhën e parasë e ka përgatitë sipas kërkesave të veta në SIMFK dhe alokimin e mjeteve nga të hyrat vetanake dhe alokimet e parakohshme bëhen gjithashtu në Komunë pas sigurimit të linjave buxhetore nga Ministria e Financave dhe Transferove bazuar në kërkesat komunale.

Gjithashtu ka vazhduar pagesa e vendimeve për ekzekutim të detyruar të buxhetit (gjygjësore apo përmbartimore) edhe në tremujorin e parë 2025 për mësimdhënës të bazuar në kontrata kolektive (përveç mësimdhënësve të kemi edhe ekzekutime tjera) në shumë prej 253,004.96 €, e që mund të vazhdojë edhe me tutje, që do të sjellë reduktim të buxhetit në kategorinë përkatëse.

1. TË HYRAT DHE SHPENZIMET BUXHETORE PËR PËRIUDHËN RAPORTUESE

Ky raport financiar është përgatitur në përputhje me SNKSP (Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik) të bazuar në paratë gatshme “Raportimi Financiar sipas Kontabilitetit të bazuar në paratë gatshme”.

Buxheti i aprovuar për vitin 2025 është 19,881,471.00 € i shpërndarë në pesë kategori ekonomike :

Kategoritë ekonomike	B. fillestar
Pagat dhe Shtesat	11,020,774.00
Mallrat dhe Shërbimet	2,846,807.00
Shërbimet Komunale	287,300.00
Subvencionet	1,147,000.00
Investimet Kapitale	4,579,590.00
Gjithsej	19,881,471.00

TABELA NR 1 RAPORTI I BUXHETIT DHE EKZEKUTIMIT TË TIJ : JANAR- MARS 2025

FONDET BURIMORE	Buxheti fillestar	Buxheti Aktual	Shpenzimet (pagesat) 2025	Shpenzimet (pagesat) 2024	% e realizimit
					3/2
0	1	2	3	4	5
GRANTI I PERGJITHSHËM	18,172,005.00	18,172,005.00	4,970,777.96	4,771,832.75	27.35
Pagat dhe Shtesat	11,020,774.00	11,020,774.00	2,807,951.35	2,621,989.19	25.48
Mallrat dhe Shërbimet	2,722,807.00	2,722,807.00	867,215.50	686,133.93	31.85
Shërbimet Komunale	287,300.00	287,300.00	83,903.51	81,349.39	29.20
Subvencionet	1,052,000.00	1,052,000.00	281,740.50	182,440.00	26.78
Shpenzimet Kapitale	3,089,124.00	3,089,124.00	929,967.10	1,199,920.24	30.10
Rezerva					
TË HYRAT VETANAKE Aktuale	1,709,466.00	1,709,466.00	128,020.50	157,014.00	7.49
Pagat dhe Shtesat			-		
Mallrat dhe Shërbimet	124,000.00	124,000.00	4,949.50	7,198.00	3.99
Shërbimet Komunale			4,700.00		-
Subvencionet	95,000.00	95,000.00	-	60,000.00	-
Shpenzimet Kapitale	1,490,466.00	1,490,466.00	118,371.00	89,816.00	7.94
Rezerva					-
TË HYRAT E BARTURA	-	-	-	-	-
Pagat dhe Shtesat					-
Mallrat dhe Shërbimet					-
Shërbimet Komunale					-
Subvencionet					-
Shpenzimet Kapitale					-
DONACIONET	-	-	-	-	
Pagat dhe Shtesat					-
Mallrat dhe Shërbimet					-
Shërbimet Komunale					-
Subvencionet					-
Shpenzimet Kapitale					-
HUAMARRJA E JASHTME	-	-	-	-	
Pagat dhe Mëditjet					
Mallrat dhe Shërbimet					
Shërbimet Komunale					
Subvencionet					
Shpenzimet Kapitale					
GJITHSEJ K.EKONOMIKE	19,881,471.00	19,881,471.00	5,098,798.46	4,928,846.75	25.65
Pagat dhe Shtesat	11,020,774.00	11,020,774.00	2,807,951.35	2,621,989.19	25.48
Mallrat dhe Shërbimet	2,846,807.00	2,846,807.00	872,165.00	693,331.93	30.64
Shërbimet Komunale	287,300.00	287,300.00	88,603.51	81,349.39	30.84
Subvencionet	1,147,000.00	1,147,000.00	281,740.50	242,440.00	24.56
Shpenzimet Kapitale	4,579,590.00	4,579,590.00	1,048,338.10	1,289,736.24	22.89

2. Raporti i Ekzekutimit te Buxhetit 2025 TABELA Nr 1


Në tabelën nr. 1 kolona 2 nuk janë prezantuar edhe te hyrat vetanake të pasqepenzuara nga viti i kaluar e qe në total janë 196,632.48, të cilat ende nuk janë ekzekutuar në sistemin "Free-Balance". Shpërndarja e tyre do të bëhet me vendimin e KK në një nga mbledhjet e ardhme posa të marrim konfirmimin nga MFP1-ja.

- Përqindja e kategorive ekonomike në pjesëmarrjen e buxhetit aktual Komunal :

Nga të dhënat e buxhetit fillestar të planifikuar del se kategoria Paga dhe Shtesa merr pjesë me 55.43 % të buxhetit të përgjithshëm , mallrat dhe shërbimet 14.32 %, komunalit 1.45 %, subvencionet 5.77 % dhe kategoria e projekteve kapitale merr pjesë me 23.03 % .

Sipas tabelës mund të shihet se shpenzimet e përgjithshme për periudhën janar-mars 2025 janë 5,098,798.46 € ose 25.65 % të buxhetit aktual.

Grafikisht:



Përqindja e fondeve burimore në pjesëmarrjen e buxhetit Komunal të aprovuar:

- Grandi qeveritarë në vlerë 18,172,005.00.00 € merr pjesë me 91.40 % të Buxhetit Komunal,
- Të hyrat vetanake Komunale në vlerë 1,709,466.00 € marrin pjesë me 8.60 %,

3. TË HYRAT VETANAKE JANAR-MARS 2025

Përveç Grandeve të pranuar nga niveli qendror, për qëllimet e shpenzimeve të përgjithshme, Komuna ka inkasuar edhe të hyra vetanake. Ekzistojnë disa kategori kryesore të hyrave vetanake komunale: tatimin në pronë, gjokat e trafikut, taksa administrative për leje ndërtimi, shërbimet e kadastrave, taksa për regjistrimin e automjeteve, por edhe të hyrat nga koncesionet si një e hyre e njëhershme etj. të cilat kanë rëndësi të madhe për buxhetin e përgjithshëm komunal . Të hyrat janar-mars 2025 të arkëtuara kanë arritur në shumën prej 355,378.95 € që paraqet 20.79 % të planifikimit vjetor, kurse në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit 2024 janë 0.62 % më të larta, për periudhën ende nuk i kemi pranuar të hyrat indirekte (gjokat) nga MF dhe Transferove të cilat do të reflektojnë edhe me % më tepër në ngritje të të hyrave komunale.

Te hyrat Vetanake komunale - Janar-mars 2025

TABELA NR. 2

PASQYRA

e të hyrave vetanake sipas drejtorive, planifikuar dhe realizuar në periudhën: Janar - Dhjetor 2025

Nr.	Përshkrimi	Kodi	Planifikimi	Realizimi		% e planit
			2025	2025	2024	5/4
1	2	3	4	5	6	7
I	Administrata dhe personeli	16323	50,100.00	7,967.69	12,742.12	15.90
1	Certifikatë lindjeje	50013	2,500.00	417.00	965.00	16.68
2	Certifikatë kurorëzimi	50014	5,500.00	731.00	832.00	13.29
3	Certifikatë vdekjeje	50015	2,200.00	448.00	432.00	20.36
4	Certifikatë – vërtetime të tjera ofiqarike	50016	37,000.00	6,065.00	9,741.00	16.39
5	Taksa administrative	50019	2,900.00	186.00	206.00	6.41
6	Sigurimi i automjeteve	50109		120.69	48.60	
7	Shitja e pasurisë komunale	50413		-	517.52	
II	Inspektimi	16645	9,000.00	1,040.00	4,330.00	11.56
1	Gjohat nga inspektorët komunal	50104	7,500.00	1,000.00	3,990.00	13.33
2	Gjohat mandatore - hudhja e mbeturinave	50114		-	-	
3	Taksa për praninë teknike të lokaleve	50205	1,500.00	40.00	340.00	2.67
III	Buxhet e Financës	17523	456,460.00	68,807.68	52,257.23	15.07
1	Tatimi në pronë	40110	344,960.00	42,871.68	27,118.23	12.43
2	Taksa për regjistrimin e automjeteve	50001	110,000.00	25,540.00	23,811.00	23.22
4	Taksat për vërtetime dhe certifikata tjera	50011	1,500.00	396.00	527.00	26.40
5	Taks Administrative	50019		-	801.00	
IV	Zhvillimi Ekonomik - Planifikimi	48023	55,000.00	850.00	2,700.00	1.55
1	Taksa komunale në biznes	50201	55,000.00	850.00	2,700.00	1.55
2	Gjohat e biznesëve nga inspektorët financiarë	50104		-	-	
IV	Shërbimet Publike e Mbrojtja Civile	18023	5,500.00	415.00	2,080.00	7.55
1	Taksa për leje parkingu	50008	5,500.00	415.00	1,980.00	7.55
V	Bujqësi dhe zhvillim rural	47023	13,550.00	16.00	100.00	0.12
1	Nderrimi i destinimit të tokës	50012	150.00	-	-	-
2	Taksa tjera administrative për bujqësi	50016	3,400.00	16.00	100.00	0.47
4	Participimet në bujqësi	50409	10,000.00	-	-	-
VII	Geodezia, Kadastru dhe Prona	65315	127,923.00	22,090.69	58,465.34	17.27
1	Trashëgimia – bartja, regjistrimi i pronës	50011	36,000.00	7,424.00	6,311.00	20.62
3	Taksë për fletë-poseduere dhe kopje plani	50032	12,623.00	1,731.00	3,275.00	13.71
4	Taksa administrative	50019	6,300.00	1,696.00	860.00	26.92
5	Renta - shfrytëzimi i pronës publike	50405	30,000.00	1,316.85	3,966.00	4.39
6	Qiraja nga objektet publike	50408	18,000.00	4,424.84	4,644.84	24.58
7	Aktivitetet në terren për matje	50504	25,000.00	5,198.00	8,576.00	20.79
8	Tax ndërrim destinimit tokës	50012		300.00	30,832.50	
VIII	Urbanizmi dhe Mbrojtja e Ambientit	66620	631,583.00	223,353.89	146,614.68	35.36
1	Lejet ndërtimore	50009	292,333.00	91,382.54	78,145.56	31.26
2	Taksat administrative	50019	250.00	573.00	540.00	229.20
3	Të hyrat nga koncesioni	50417	316,000.00	130,000.00	52,891.60	41.14
4	Takse komunale për leje mjedisi	50045	10,500.00	587.64	13,162.63	5.60
0	Legalizimi i Objekteve Ndërtimore	50026	12,500.00	810.71	1,874.89	6.49
IX	Shëndetësia dhe Mirëqenia Sociale	73032	16,800.00	5,534.00	5,800.00	32.94
1	Taksa administrative DSHMS	50019	13,500.00	5,534.00	5,800.00	40.99
a	Shtëpia e shëndetit QKMF	74400	38,000.00	7,602.00	7,829.00	20.01
1	Participimi - arka	50409	32,000.00	6,702.00	6,839.00	20.94
2	Certifikatë mieku	50024	6,000.00	900.00	990.00	15.00
XI	Kultura, Rinia e Sporti	85023	450.00	-	-	-
1	Qiraja nga objektet publike	50408		-	-	-
2	Participimi nga KRS (biblioteka)	50409	450.00	-	-	-
XII	Arsimi – qerdhja e fëmijëve	92650	55,000.00	17,702.00	13,040.00	32.19
1	Shitja e shërbimeve	50401		-	-	-
2	Qiraja nga objektet publike	50408		-	-	-
3	Participimi për kujdesin e fëmijëve	50409	55,000.00	17,702.00	13,040.00	32.19
4	Participimi për kujdesin e fëmijëve-Bajë	50409		-	-	-
GJITHSEJ TË HYRAT			1,459,366.00	355,378.95	305,958.37	24.35
Te Hyrat tjera - Gjohat nga Trafiku, Gjykata, e tjera			250,100.00	-	47,205.00	-
1	Të hyrat nga gjohat në trafik	50101	180,000.00	-	35,815.00	-
2	Të hyrat nga gjohat e gjykatave	50102	70,000.00	-	11,390.00	-
3	Të hyrat nga Agjensioni përvojë e tjera	50107	100.00	-	-	-
GJITHSEJ TË HYRAT KOMUNALE			1,709,466.00	355,378.95	353,163.37	20.79

4. SHPENZIMET BUXHETORE

Shpenzimet e komunës janë realizuar përmes pesë kategorive ekonomike të parapara me Ligjin e buxhetit nr. 08/L-332 për vitin 2025 duke përjashtuar vendimet gjyqësore dhe përmbarimore që mund të janë shpenzime të paplanifikuara dhe atë:

- a. *Paga dhe shtesa*
- b. *Mallra dhe shërbime*
